



100 BFM Përmendje

## BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 8638 d.d. 14.09.2012

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Bashkisë së Tiranës  
dhe

Shkollës 9 vjeçare "Konferenca e Pezës", Tiranë  
dhe

Grupit të të rinjve të Njësisë Bashkiake nr. 10

Nënshkruar sot në Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2012

Ky memorandum hartohet ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe Shkollës 9 vjeçare "Konferenca e Pezës" për projektin "Terrene sportive, mqedise pushimi dhe argëtimi" i zhvilluar në kuadër të nënkomponentit C të projektit "Youth Empowerment through Community Development" (YECD).

Projekti do të implementohet në ambientet e Shkollës 9 vjeçare "Konferenca e Pezës" dhe do të përfshijë të rinjtë e shkollës dhe komunitetit të zonës në Njësinë Bashkiake nr.10.

Në kuadër të këtij projekti në ambientet e Shkollës 9 vjeçare "Konferenca e Pezës" e vendosur në rrugën "Him Kolli", Njësia Bashkiake nr.10, Tiranë, do të krijohen ambiente sportive, pushimi e argëtimi: *fushë multifunksionale (basketbolli, volejbolli dhe minifutbolli), pistë vrapimi, kënd lodrash dhe hapësira të gjelbra*, si një premisë për zhvillimin e aktiviteteve të projektit.

Nëpërmjet këtij Memorandumi Bashkëpunimi, partnerët në marrëveshje bien dakord si më poshtë:

Neni 1  
Qëllimi:

Qëllimi i këtij "Memorandumi Bashkëpunimi" është koordinimi dhe zbatimi i aktiviteteve të projektit "Terrene sportive, mqedise pushimi dhe argëtimi" i cili do të zbatohet në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Konferenca e Pezës".

## **Neni 2** **Detyrimet e palëve**

### 2.1 Bashkia e Tiranës merr përsipër:

- a. Të ngarkojë Drejtorinë e Planifikimit të Territorit për dizenzimin e projektit teknik sipas standardeve në shkolla dhe Drejtorinë e Rinisë dhe Sporteve për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të projektit. Këto dy struktura do të janë përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve të projektit në bashkëpunim me Njësinë Bashkiakë nr.10, shkollën 9 vjeçare "Konferenca e Pezës" dhe komunitetin e të rinjve të zonës.
- b. Të hartojë, në bashkëpunim me përfituesit e projektit (grupin e të rinjve dhe stafin e shkollës) dhe të paraqesë pranë Njësisë së Koordinimit të Projektit YECD, projekt propozimin "Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim".
- c. Të hartojë në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Konferenca e Pezës" dhe grupin e të rinjve, planin vjetor të aktiviteteve të projektit.
- d. Me anë të financimit të JSDF (Japan Social Development Fund), nëpërmjet Njësisë së Koordinimit të Projektit YECD, do të krijojë terrene sportive, pushimi dhe argëtimi në përputhje me projekt propozimin e hartuar nga partnerët e projektit.
- e. Mbas investimit të bërë, të kujdeset për mirëmbajtjen në vazhdimësi të ambienteve të krijuara nëpërmjet Drejtorisë nr.3 të Punëtorëve të Qytetit.
- f. Të përdorë në vazhdimësi këto ambiente të krijuara edhe pas përfundimit të këtyj projekti, për aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me palët e tjera, për eventet e planifikuara në kuadër të projekteve të tjera me impakt komunitar, social, sportiv, rinor, etj.

### 2.2 Shkolla 9-vjeçare "Konferenca e Pezës" merr përsipër:

- a. Të vërë në dispozicion të projektit "Krijimi i terreneve sportive, mjediseve për pushim dhe argëtim", ambientin ku do të zbatohet projekti.
- b. Të marrë në dorëzim investimin e mundësuar nga projekti dhe të përgjigjet për mirëmbajtjen e ditëpërditshme dhe ruajtjen e ambienteve të krijuara.
- c. Të përdorë terrenet sportive të pushimit dhe argëtimit për realizimin e aktiviteteve ndërmjet të rinjve të shkollës si dhe do jetë e hapur për aktivitete që do të realizohen me të rinjtë e komunitetit, sipas planit të aktiviteteve të projektit.
- d. Të caktojë stafin përkatës që do të angazhohet në realizimin e aktiviteteve të projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
- e. Të dokumentojë të gjitha aktivitetet e realizuara nga shkolla në kuadër të projektit nëpërmjet fotove, video-regjistrimeve të aktiviteteve apo proces verbaleve të mbajtura.

- f. Të vërë në dispozicion dhe në vazhdimësi ambientet e krijuara për aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës për eventet e planifikuar në kuadër të projekteve të tjera me impakt komunitar, social, sportiv, rinos, etj.

2.3 Grupi i të rinjve merr përsipër:

- Të angazhohet dhe marrë pjesë në hartimin dhe realizimin e aktivitetave të projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Shkollën "Konferenca e Pezës".
- Të bëhen pjesë dhe të përfshihen në vendimmarrjen për aktivitetet e projektit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

**Neni 3**  
**Dispozita të fundit**

3.1 Palët përgjigjen për respektimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi

3.2 Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3 vjeçare, duke filluar nga data e hryjes në fuqi.

3.3 Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në 6 kopje, nga 2 kopje për secilën palë.


Për Bashkinë e Tiranës

Znj. Jorida TABAKU  
Zv/ Kryetare



Për shkollën 9-vjeçare "Konferenca e Pezës"

Znj. Alma KOCIAJ  
Drejtore



Për grupin e të rinjve

Johana SELIMAJ

